



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Rruga Naim Frashëri Nr 37, Tiranë , ALBANIA

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR EFEKT MARRJEN E
SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË LËNDËS
MATEMATIKË**

1. HYRJE

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të lëndës së matematikës është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA, për t'u ardhur në ndihmë të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve, si dhe të gjithë mësuesve të lëndës së matematikës në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e shkallëve të kualifikimit. Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MASH-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentet zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve,
- programet përkatëse lëndore,
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK në mësimdhënie-nxënie në përgjithësi dhe të lëndës së matematikës në veçanti,
- përmbajtjen shkencore të lëndës sipas programeve lëndore përkatëse.

2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të matematikës është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi është hartuar nga grupi i punës duke mbajtur parasysh dy qëllime kryesore:

¹ Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASH që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- të ofrohet si një program orientues për t'u ardhur në ndihmë Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve si dhe të gjithë mësuesve të lëndës së matematikës në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese në bazë rrethi. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrohet si një program i detyruar, për mësuesit që këtë vit do të marrin shkallët e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- rritjen e kompetencave profesionale të kuadrit mësime, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësime të suksesshme;
- rritjen e aftësive në fushën pedagogjike për mësime strategjike, për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave për vlerësimin e nxënësve etj;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- demonstrimin konkret të aftësive e kompetencave të fituara, në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit;
- rritjen e kompetencave në përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si një nga risitë më të fundit në mësime bashkëkohore.

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të matematikës është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, përpos kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së matematikës që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij si dhe çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet

që priten të zotërojnë mësuesit në fushën e njohurive dhe aftësive si dhe literatura përkatëse rekomanduese në funksion të tyre.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	
Fusha : Dokumentet zyrtare	
Kompetenca	
Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet</p> <p>Mësuesi i matematikës duhet të jetë i aftë të...</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegojë ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe dispozitat normative të këtij sistemi; • zbatojë legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; • zbatojë legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për funksionimin e strukturave organizative të shkollës; • zbatojë legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; • demonstrojë zbatimin konkret të udhëzimeve të MASH në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; • zbatojë etikën profesionale të mësuesit; • respektojë të drejtat dhe liritë e nxënësit; • respektojë detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; • zbatojë rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji i sistemit arsimor parauniversitar • Nenet 14; 20; 21; 22; 26; 27 • Dispozitat Normative për arsimin parauniversitar (DN). • Të drejtat e nxënësve (Neni 21) të DN. • Qeveria e nxënësve (Neni 37) të DN. • Mësuesi, të drejtat e detyrat (Nenet 43,44,45) DN. • Organet kolegjiale në shkollë (Nenet 51, 53, 54) të DN. • Udhëzimi Nr. 49, dt. 27.12.2006 i MASH "Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve". • Udhëzimi Nr.38 , dt.09.10.2007 i MASH "Për zhvillimin e orëve të lira në shkollë". • Udhëzimi Nr. 35, dt.09.10.2007 i MASH "Për lirinë e mësuesit për orët mësimore të parashikuara në programin lëndor". • Udhëzimi Nr. 37, dt.09.10.2007 i MASH "Për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore". • Udhëzimi Nr. 21, datë 23.07.2010 "Për normat e punës mësimore edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e Arsimit Parauniversitar". • Udhëzimi i MASH, Nr. 26 datë 10.08.2010 "Për mbarëvajtjen e punës mësimore edukative në sistemin e Arsimit Parauniversitar në vitin shkollor 2010-2011. • Udhëzimi i Alterteksit 2010-2011 • Rregulloren Nr 4998, datë 27.07.2010 për vlerësimin e nxënësit në gjimnaz • Udhëzimi dhe rregullorja për kualifikimin e mësuesve 2010 - 2011

Fusha : Programet lëndore

Kompetenca

Zbatimi me efektivitet i programeve të matematikës në shkollë

Literatura e rekomanduar

Rezultatet

Mësuesi i matematikës duhet të jetë i aftë të...

- zbatojë programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij;
- përdorë, me krijueshmëri, programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim;
- përdorë me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit;
- gjejë ose të hartojë materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;
- gjejë ose të hartojë materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre;
- hartojë objektiva për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me objektivat e programit;
- kategorizojë objektivat e programit sipas shkallëve të taksonomisë së Blumit;
- hartojë objektiva specifike që u përgjigjen niveleve të ndryshme të nxënësve;
- tregojë koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të matematikës);
- shpjegojë përdorimin e objektivave të programit për vlerësimin e nxënësve;
- shpjegojë parimet e hartimit të një testi;
- shpjegojë lidhjen program-tekst nxënësi;
- përzgjedhë mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit;
- planifikojë një orë mësimore me të gjitha hapat e njëpasnjëshëm;
- sigurojë informacion që demonstroi lidhjen e matematikës me shkencat e tjera dhe me jetën reale.

- Programet aktuale lëndore të matematikës për arsimin parauniversitar (1-9 dhe 10-12)
- Kurrikula e arsimit nëntë vjeçar, Matematika, “Udhëzues për mësuesit”, IKS, 2006
- “Braktisja e fshehtë. Objektivat minimale të domosdoshme për nxënësin” (kreu i parë, kreu i dytë, kreu i tretë) S.Llambiri, Unicef, Tiranë 2007
- Udhëzuesi lëndor i matematikës së gjimnazit, IKT, 2009
- Module për mësuesit e matematikës, ISP, 2003, 2004
- Objektivat e arritjeve të kapitullit (linjës), QTKA, Nëntor 2007.
- Hartimi i objektivave të arritjes së nxënësve, IKT, 2008
- Udhëzuesi kurrikular i gjimnazit, IZHA, 2010

Fusha : Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK në mësimdhënie-nxënie

<p>Kompetenca I</p> <p>Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e matematikës</p> <p>Kompetenca II</p> <p>Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e matematikës</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet</p> <p>Mësuesi i matematikës duhet të jetë i aftë të...</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshtatë punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; • të demonstrojë respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; • identifikojë nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); • planifikojë punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të vecanta; • demonstrojë qëndrim pozitiv ndaj shkencës dhe lëndës së matematikës; • edukojë te nxënësit një qëndrim pozitiv ndaj lëndës së matematikës; • motivojë nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelsat e progresit të tyre; • dallojë mënyrat e nxënies dhe të përshtasë mësimdhënien me to; • krijojë mjedis mësimor të përshtatshëm, motivues dhe të kënaqshëm për nxënësit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbi pedagogjinë, Jean Piaget, botim i IKS, 2005 (kapitulli 9,12,16,17) • Psikologjia shkollore, Fakulteti i shkencave Sociale, E.Rapti (pjesa e katërt,faqe 68-94). • Të gjithë ne jemi inteligjentë, Botim i CDE (Inteligjenca logjike matematikore, faqe 17) • Menaxhimi i klasës, Fakulteti i Shkencave Sociale (kapitulli 1, 2 dhe 10; faqe 1-28 dhe 156-166), Th.Karaj
<ul style="list-style-type: none"> • përzgjedhë metodat, strategjitë dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objekti të caktuar; • përdorë metoda e strategji që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; • përdorë metoda e strategji që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; • përdorë metoda e strategji që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; 	<ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënia me në qendër nxënësin. Botim IKS 2005 • Metodat ndërvepruese të mësimin - IKT, 2008 • Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues: Matematika klasa 6-12 (mësime model faqe 7-21) B.Musai, Botim i CDE • Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues: matematika dhe shkencat natyrore klasa 6-12, B.Musai, botim i CDE, 2005 (faqe 47-72; 90-96;

<ul style="list-style-type: none"> • përdorë strategji të ndryshme të zgjidhjes problemore; • përzgjedhë metoda teknika e strategji të cilat zhvillojnë arsyetimin dhe komunikimin matematik; • zbatojë metoda e strategji që edukojnë një qëndrim pozitiv ndaj lëndës së matematikës. 	<p>146-166</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hyrje në mësimdhënien e diferencuar, Tiranë, QTKA, 2006 • Kurrikula e arsimit nëntë vjeçar, Matematika, “Udhëzues për mësuesit”, IKS, 2006 • Udhëzues për zhvillimin e Kurrikulës, IKS, 2006 • Udhëzuesi lëndor i matematikës së gjimnazit, IKT, 2009 • Udhëzues për kurrikulën e gjimnazit, IZHA 2010 • “Kualifikimi i mësuesve – Teste 2008, 2009 2010”, botime të IKT • Korniza kurrikulare e gjimnazit. IKT 2009
<p>Kompetenca III</p> <p>Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në matematikë</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet</p> <p>Mësuesi i matematikës duhet të jetë i aftë të...</p> <ul style="list-style-type: none"> • prezantojë materiale matematikore duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel, Math Type në Word; • nxitë nxënësit të bëjnë prezantime në matematikë duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; • gjejë dhe të përdorë materiale nga Website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënien-nxënien; • përfshijë nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së matematikës apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthurren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga website. 	<ul style="list-style-type: none"> • Tekstet e informatikës për shkollat e mesme

Fusha : Përmbajtja shkencore e lëndës

Kompetenca

Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimitdhënien e lëndës së matematikës

Literatura e rekomanduar

Rezultatet

Mësuesi i matematikës duhet të jetë i aftë të...

- dallojë konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e matematikës në 1-9/10-12;
- përshkruajë mënyrën e formimit të koncepteve matematikore 1-9/10-12;
- përshkruajë zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehjeve;
- dallojë ndërvarësinë e koncepteve matematikore nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera;
- zgjidhë me saktësi dhe me mënyra të ndryshme situata problemore matematike të cilat përdorin konceptet dhe aftësitë e programeve 1-9/10-12;
- mbledhë informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij rreth vlerave përdoruese të matematikës në shkencat tjera dhe në jetën e përditshme.

- Tekste shkollore në përdorim për matematikës 1-9, të miratuara nga MASH
- Tekste shkollore në përdorim për matematikën 10-12, të miratuara nga MASH
- Botime të ndryshme me ushtrime dhe problema për lëndën e matematikës
- “Kualifikimi i mësuesve – Teste 2008, 2009 2010”, botime të IKT
- Teste Model. Botim i AVA. Tiranë 2007, 2008, 2009, 2010